

**ADRIATIC BAY INVESTMENT GROUP SH.P.K**  
**Shenimet shpjeguese për periudhën nga data 01\_01\_2019 deri më 31\_12\_2019**

(vlerat në LEK)

Per periudhen e mbyllur nga data 01.01.2019 deri me  
 31.12.2019

	Shenime Shpjeguese	Viti 2019
<b>FLUKSI I PARASË NGA AKTIVITETI OPERATIV</b>		
<b>Humbja /Fitime para tatimit</b>		<b>(1,270,306)</b>
<i>Rregullime për:</i>		
Amortizimi dhe zhvleresimi		-
Shpenzime per interesat	14	29,020
<b>Fluksi i parasë nga aktivitetet operative para rregullimeve në kapitalin qarkullues</b>		<b>(1,241,286)</b>
Ndryshim ne llogari te arketueshme dhe parapagime		(304,525,000)
Ndryshime ne inventare		-
Ndryshim ne detyrimet korrente	10	1,223,483
<b>Fluksi i parasë i gjeneruar nga aktivitetet operative</b>		<b>(304,542,803)</b>
Tatim fitimi i paguar		-
Interesa, komisione te paguara	14	(29,020)
<b>Fluksi i parasë neto gjeneruar nga aktivitetet operative</b>		<b>(304,571,823)</b>
<b>FLUKSI I PARASË NGA AKTIVITETET INVESTUESE</b>		
Blerje te ndryshme ne asetet dhe aktive ne proces		-
<b>Fluksi i parasë neto përdorur në aktivitetet investuese</b>		<b>-</b>
<b>FLUKSI I PARASË NGA AKTIVITETE FINANCUESE</b>		
Kontribute te aksionareve ne kapital		-
Te hyra nga disbursim hua dhe te ngjashme	10	304,525,000
<b>Fluksi i parase neto përdorur për aktivitetet financuese</b>	5	<b>304,525,000</b>
<b>Fluksi neto i parasë dhe ekuivalentët</b>		<b>(46,823)</b>
Para dhe ekuivalentë në fillim të periudhes		48,291
<b>Para dhe ekuivalentë në fund të periudhes</b>	4	<b>1,468</b>

Shënimet bashkëngjitur janë 14 janë pjesë e pandarë e këtyre pasqyrave financiare.



## ADRIATIC BAY INVESTMENT GROUP SH.P.K

Shenimet shpjeguese për periudhën nga data 01\_01\_2019 deri më 31\_12\_2019

---

(vlerat në LEK)

### 1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Shoqëria Adriatic Bay Investment Group shpk e regjistruar me 11 nëntor 2018 me NUIS: L82320043A dhe seli në adresën: Sheshi Italia, Mark Albania Hotel, kati i pare, 1000 Tirane, kryen aktivitetin e saj për investime dhe shërbime në fushën e hidrokarbureve, shërbime portuale dhe doganore, si dhe shërbime të ndryshme detare. Gjithashtu shoqëria ka si aktivitet edhe pjesëmarrje dhe iniciativa të tjera koncesionare.

### 2. BAZAT E PËRGATITJES TE PASQYRAVE FINANCIARE

Këto pasqyra financiare, janë pasqyra për qëllime të përgjithshme raportimi ligjor dhe janë përgatitur sipas kërkesave të ligjit "Mbi Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" nr. 25/2018 datë 10.05.2018 dhe Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit .

### 3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL

#### 3.1. Monedha funksionale dhe raportuese

Monedha funksionale e Shoqërisë është Leku Shqiptar (LEK), e cila është monedha e përdorur në mjedisin ekonomik në të cilin Shoqëria ushtron veprimtarinë. Shoqëria përgatit dhe raporton pasqyrat e saj financiare në LEK. Transaksionet konvertohen fillimisht duke përdorur kursin e këmbimit midis monedhës së huaj dhe monedhës funksionale në momentin e kryerjes së veprimit që është momenti kur veprimi kualifikohet për njohje në pasqyrat financiare. Në fund të çdo periudhe raportuese, aktivet monetare konvertohen me kursin e fundit të periudhës raportuese. Aktivet jo-monetare mbahen me kosto historike dhe konvertohen në monedhën raportuese me kurset historike të transaksioneve.

Kursi i këmbimit të LEK-ut përkundrejt monedhës Euro më 31 dhjetor 2019 është si në vijim:

**31 Dhjetor 2019**

LEK/EURO

121.77

Për aktivet monetare, diferencat që rezultojnë nga konvertimi reflektohen në rezultatin e vitit. Kur diferencat rezultojnë nga zëra jomonetarë ato kalojnë në fitim ose humbje; çfarëdo difference e realizuar nga këmbimet valutore kalon në rezultatin e periudhës. Kur fitimi dhe humbja e zërave jomonetarë njihen në kapitalin neto, edhe diferencat nga këmbimet njihen në kapitalin neto.



(vlerat në LEK)

### 3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

#### 3.2. Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët të saj përfshijnë llogari rrjedhëse bankare, para në dorë, depozita me bankat dhe të tjera mjete që janë likuide dhe maturiteti i tyre i mbetur në një datë raportimi nuk është më shumë se 3 muaj.

#### 3.3. Instrumenta financiare

Aktivet dhe detyrimet financiare njihen kur Shoqëria bëhet pjesë e një marrëdhënieje kontraktuale me të tretë në lidhje me këto instrumenta financiare.

#### 3.4. Aktive financiare

Llogari të arkëtueshme dhe të tjera janë aktive financiare që përfaqësojnë një të drejtë kontraktuale për të marrë para në të ardhmen.

#### 3.5. Të ardhurat

Të ardhura konsiderohen hyrjet bruto të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës të cilat lindin si pasojë e veprimtarisë dhe aktivitetit normal të Shoqërisë.

Në periudhën nga data 1 Janar 2019 deri më 31 dhjetor 2019 Shoqëria nuk ka gjeneruar të ardhura nga aktiviteti.

E ardhura matet me vlerën e drejtë të përfitimeve të marra ose të arkëtueshme. Vlera e të ardhurave njihet neto nga zbritjet tregtare ose rabatet e marra.

#### 3.6. Shpenzime huamarrje

Të gjitha shpenzimet e huamarrjeve dhe shpenzimet financiare të tjera njihen direkt në rezultatin e vitit në momentin kur ndodhin.

---



**ADRIATIC BAY INVESTMENT GROUP SH.P.K****Shenimet shpjeguese për periudhën nga data 01\_01\_2019 deri më 31\_12\_2019***(vlerat në LEK)***3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)****3.7. Tatim fitimi**

Shpenzimi për tatim fitimin përfaqëson totalin e tatim fitimit të periudhës. Shpenzimi i vitit për tatim fitimin përllogaritet duke përdorur normën e tatim fitimit e cila është e aplikueshme në fund të periudhës raportuese.

Shoqëria për periudhën nga data 1 Janar 2019 deri më 31 dhjetor 2019 nuk ka pasur aktivitet dhe për rrjedhojë nuk ka gjeneruar të ardhura të tatueshme.

**4. PARA NE ARKË DHE BANKË**

Para në arkë dhe bankë më 31 dhjetor 2019 janë si në vijim:

<b>Para ne arke dhe banke</b>	<b>31- Dhjetor-2019</b>	<b>31 Dhjetor 2018</b>
Para ne banke	1,468	48,291
Para ne arke	-	-
<b>Totali i parave ne arke dhe banke</b>	<b>1,468</b>	<b>48,291</b>

**5. LLOGARI TE ARKETUESHME DHE PARAPAGIME**

Llogari te arketueshme më 31 dhjetor 2019 janë si në vijim:

<b>Llogari te arketueshme dhe parapagime</b>	<b>31- Dhjetor-2019</b>	<b>31 Dhjetor 2018</b>
TVSH e rimbursueshme	-	-
Parapagime ndaj furnitoreve dhe nenkontraktoreve	-	-
Te tjera te arketueshme	304,525,000	-
<b>Totali i llogarive te arketueshme dhe parapagime</b>	<b>304,525,000</b>	<b>-</b>

**ADRIATIC BAY INVESTMENT GROUP SH.P.K**

**Shenimet shpjeguese për periudhën nga data 01\_01\_2019 deri më 31\_12\_2019**

(vlerat në LEK)

**6. INVENTARE**

Shoqëria nuk ka pasur aktivitet gjatë periudhës 01 Janar 2019 deri me 31 Dhjetor 2019 ,per kete arsye gjendia e inventarit rezulton zero .

**7. AKTIVE MATERIALE DHE JO MATERIALE**

Shoqëria nuk rezulton te kete pasur regjistrime aktivesh gjate periudhes 01 Janar 2019 deri me 31 Dhjetor 2019 .

**8. AKTIVE NE PROCES**

Shoqëria nuk rezulton te kete pasur aktivitet ndertimi e investimi gjate periudhes 01 Janar 2019 deri me 31 Dhjetor 2019 .

**9. KAPITALI AKSIONAR**

Më 11 nentor 2018, dy ortakët Kastrati SHA dhe Europetrol Group SHA kanë themeluar shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar Adriatic Bat Investmetn Group Shpk.

Më 31 dhjetor 2019 nuk figuron te kete pasur ndryshime ne strukturen e e kapitalit te regjistruar te Shoqërisë i cili është 100 LEK i ndarë sipas strukturës në vijim:

	%	31 dhjetor 2019
Kastrati sha	65	65
Europetrol Group sha	35	35
<b>Totali</b>		<b>100</b>

Kapitali aksionar më 31 dhjetor 2019 është paguar për kontributin e kapitalit.

**10. DETYRIME JO-KORRENTE**

Gjatë periudhës 01 Janar 2019 deri me 31 dhjetor 2019 ,rezulton qe shoqëria ka hyre ne marredhenie humaraje afatgjate e cila paraqitet si me poshte :

Detyrime jo-korrente	31- Dhjetor-2019	31 Dhjetor 2018
Detyrime bankare dhe te ngjashme	304,525,000	-



**ADRIATIC BAY INVESTMENT GROUP SH.P.K**  
**Shenimet shpjeguese për periudhën nga data 01\_01\_2019 deri më 31\_12\_2019**

(vlerat në LEK)

**11. DETYRIME TE TJERA KORRENTE**

Detyrime te tjera korente per periudhen 01 Janar 2019 deri me 31 Dhjetor 2019 paraqiten si me poshte :

<b>Detyrimeve te tjera korrente</b>	<b>31- Dhjetor-2019</b>	<b>31 Dhjetor 2018</b>
Te pagueshme ndaj ortakut	-	-
Te pagueshme ndaj te treteve	958,200	50,000
Furnitore dhe nenkontraktore	342,000	-
Detyrime ndaj personelit	60,529	72,529
Per sigurime shoq., shendetesore dhe TAP	5,923	20,640
<b>Totali i detyrimeve te tjera korrente</b>	<b>1,366,652</b>	<b>143,169</b>

**12. TE ARDHURA NGA SHITJA**

Shoqeria nuk ka pasur aktivitet për periudhën e mbyllur nga data 1 Janar 2019 deri më 31 Dhjetor 2019.

**13. SHPENZIME ADMINISTRATIVE**

Shpenzimet administrative per periudhën e mbyllur nga data 1 Janar 2019 deri më 31 Dhjetor 2019 paraqiten si në vijim:

<b>Shpenzime administrative</b>	<b>31- Dhjetor-2019</b>	<b>31 Dhjetor 2018</b>
Paga per personelin	719,812	83,549
Energji, karburant, uje etj	-	-
Amortizimi dhe zhvleresimi	-	-
Qira	342,000	-
Taksa dhe tarifa te ndryshme	117,833	-
Konsulence dhe sherbime profesionale	-	-
Sigurime shoqerore dhe shendetesore	48,236	10,421
Te tjera administrative	-	-
<b>Totali i shpenzimeve administrative</b>	<b>1,227,881</b>	<b>93,970</b>



**ADRIATIC BAY INVESTMENT GROUP SH.P.K****Shenimet shpjeguese për periudhën nga data 01\_01\_2019 deri më 31\_12\_2019***(vlerat në LEK)***14. SHPENZIME TË TJERA**

Shpenzime të tjera për periudhën e mbyllur nga data 1 Janar 2019 deri më 31 Dhjetor 2019 përfaqësojnë shpenzime dhe komisione bankare te cilat paraqiten si ne vijim :

**Shpenzime te tjera, neto**

Interesa dhe komisione bankare	29,020	900
Te ardhura neto nga rivleresim i arkes dhe banks	(91)	-
Te tjera shpenzime, neto	13,495	8
<b>Totali i shpenzimeve te tjera, neto</b>	<b>42,424</b>	<b>908</b>

**15. TATIM FITIMI**

Shoqëria për periudhën nga data nga data 1 Janar 2019 deri më 31 Dhjetor 2019 nuk ka pasur aktivitet dhe për rrjedhojë nuk janë gjeneruar të ardhura të tatueshme.

**Periudha nga data  
1 Janar 2019 deri  
më 31 Dhjetor 2019**

<b>Humbja para tatimit</b>	<b>(1,270,306)</b>
<i>Diferenca të përkohshme për të cilat nuk është njohur tatim i shtyrë:</i>	-
<i>Rregullime për shpenzime të panjohura:</i>	<b>10,495</b>
<b>Fitim i tatueshëm i vitit</b>	<b>(1,259,811)</b>
<b>Shpenzimi për tatim fitimin me 15%</b>	-

**16. NGJARJE PAS PERIUDHËS RAPORTUESE**

Pas datës së perpilimit te pasqyrave financiare, nuk ka pasur ngjarje për të cilat të nevojiten rregullime në pasqyrat financiare të Shoqërisë ,apo te lihen komente shtese ne shenimet shpjeguese.

**Administratori**

Ahmet KASTRATI

